


# Indeksi i Çmimeve të Importit

## Tremujori III, 2022

**Tiranë, më 06 Dhjetor 2022:** Indeksi i Çmimeve të Importit, në tremujorin e tretë të vitit 2022, arriti 111,5 kundrejt vitit 2020. Krahasuar me tremujorin e tretë 2021, indeksi i çmimeve të importit shënoi një rritje me 8,1 %, një vit më parë ky ndryshim ishte 3,3 %. Krahasuar me tremujorin e dytë 2022 indeksi shënoi një ulje me 0,6 %.

Fig.1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Importit sipas tremujorëve



**Ndryshimi vjetor:** Çmimet e importit të produkteve në seksionin “Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar” kanë shënuar rritje me 39,9 %. Indeksi në seksionin “Industri nxjerrëse” shënoi një rritje me 11,8 %, krahasuar me një vit më parë. Indeksi në seksionin “Industria përpunuese” me peshën më të madhe prej 91,4 % shënoi një rritje me 6,5 %. Brenda këtij seksioni rritja më e madhe e çmimeve vërehet në produktet e aktivitetit “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 14,2 %, pasuar nga “Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara” me 12,1 %, “Metalurgjia” me 11,6 %, aktivitetet “Prodhimi i produkteve minerale jo metalike” me 11,1 %, “Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit” me 10,9 %, “Prodhimi i pijeve” me 9,7 %, “Prodhimi i tekstileve” me 8,2 %, “Prodhimi i pajisjeve elektrike” me 8,1 %, “Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë” me 8,0 %, “Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës” me 7,4 %, etj.

**Për publikim 06/12/2022**

**Ndryshimi Tremujor:** Krahasuar me tremujorin e dytë 2022, çmimet e importit të produkteve në seksionin “Industria përpunuese”, kanë shënuar ulje me 0,9 %. Brenda këtij seksioni ulja më e madhe e çmimeve vërehet në produktet e aktivitetit “Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës” me 6,6 %, pasuar nga “Metalurgjia” me 4,8 %, “Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara” me 2,9 %, etj. Ulje shënoi edhe seksionin “Industri nxjerrëse” me 0,1 %. Nga ana tjetër, çmimet në seksionet “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” dhe “Energjia elektrike, gaz, avulli dhe ajri kondicionuar”u rritën respektivisht me 4,7 % dhe 2,7 %.

**Tab.1 Indeksi i Çmimeve të Importit**

2020=100

NVE Rev.2	Përshkrimi	Peshat	07-22	08-22	09-22	III-22
	<b>Gjithsej</b>	<b>100,0</b>	<b>111,4</b>	<b>111,4</b>	<b>111,7</b>	<b>111,5</b>
<b>B</b>	<b>Industri Nxjerrëse</b>	<b>0,2</b>	<b>114,7</b>	<b>114,8</b>	<b>114,8</b>	<b>114,8</b>
08	Nxjerja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,2	114,7	114,8	114,8	114,8
<b>C</b>	<b>Industria Përpunuese</b>	<b>91,4</b>	<b>108,8</b>	<b>108,6</b>	<b>109,0</b>	<b>108,8</b>
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	24,8	117,2	117,2	117,1	117,2
11	Prodhimi i pijeve	24,4	115,5	115,6	115,6	115,6
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	25,3	106,7	106,7	110,6	108,0
13	Përpunimi i tekstileve	29,9	109,1	108,6	108,4	108,7
14	Konfeksionimi i veshjeve	17,8	105,5	105,7	105,8	105,6
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	11,8	107,6	107,2	107,0	107,3
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilie; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	17,0	107,1	107,3	107,3	107,2
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letre	0,0	105,2	105,2	105,2	105,2
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	56,9	111,1	111,1	110,6	110,9
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	61,7	112,8	113,4	113,2	113,1
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	85,9	107,5	107,6	107,3	107,5
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	30,6	101,6	101,6	101,6	101,6
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	23,4	103,5	103,5	103,6	103,5
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	44,1	112,8	112,9	112,0	112,6
24	Metalurgjia	29,6	116,7	112,4	117,9	115,7
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	41,7	104,8	104,9	104,7	104,8
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	46,9	108,1	108,1	108,1	108,1
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	37,7	109,8	110,3	110,3	110,2
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t	2,5	103,4	103,5	103,5	103,5
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	16,9	113,5	113,5	113,9	113,6
31	Prodhimi i mobiljeve	59,3	104,4	104,4	104,4	104,4
32	Industri të tjera p,k,t	7,7	104,6	104,9	104,8	104,8
<b>D</b>	<b>Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar</b>	<b>7,5</b>	<b>181,6</b>	<b>184,5</b>	<b>184,0</b>	<b>183,4</b>
35	Energjia elektrike, gaz, avulli dhe ajri kondicionuar	7,5	181,6	184,5	184,0	183,4
<b>E</b>	<b>Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve</b>	<b>1,0</b>	<b>112,8</b>	<b>112,8</b>	<b>112,5</b>	<b>112,7</b>
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,0	112,8	112,8	112,5	112,7

Tab.2 Ndryshimet tremujore dhe vjetore të Indeksit të Çmimeve të Importit

në %

NVE	Përshkrimi	Peshat	III- 22 /II- 22	III- 22 / III- 21
	<b>Gjithsej</b>	<b>100,0</b>	<b>-0,6</b>	<b>8,1</b>
<b>B</b>	<b>Industri Nxjerrëse</b>	<b>0,2</b>	<b>-0,1</b>	<b>11,8</b>
08	Nxjerja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,2	-0,1	11,8
<b>C</b>	<b>Industria Përpunuese</b>	<b>91,4</b>	<b>-0,9</b>	<b>6,5</b>
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	24,8	0,3	14,2
11	Prodhimi i pijeve	24,4	0,3	9,7
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	25,3	0,7	5,7
13	Përpunimi i tekstileve	29,9	1,6	8,2
14	Konfeksionimi i veshjeve	17,8	-0,9	3,5
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	11,8	2,6	4,9
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobilie; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	17,0	0,0	5,2
17	Prodhimi i letres dhe produkteve prej letre	0,0	-1,1	6,3
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	56,9	-2,9	12,1
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	61,7	-6,6	7,4
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	85,9	-1,5	5,1
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	30,6	2,7	0,5
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	23,4	-1,1	2,0
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	44,1	-0,8	11,1
24	Metalurgjia	29,6	-4,8	11,6
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	41,7	-1,2	4,7
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	46,9	-1,0	8,0
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	37,7	-0,2	8,1
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t	2,5	-1,6	0,4
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	16,9	-1,4	10,9
31	Prodhimi i mobilie	59,3	-2,0	3,2
32	Industri të tjera p,k,t	7,7	-0,2	5,8
<b>D</b>	<b>Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar</b>	<b>7,5</b>	<b>2,7</b>	<b>39,9</b>
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	7,5	2,7	39,9
<b>E</b>	<b>Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve</b>	<b>1,0</b>	<b>4,7</b>	<b>7,7</b>
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,0	4,7	7,7

# Metodologjia

**Indeksi i Çmimeve të Importit** mat ecurinë e çmimeve të transaksioneve të produkteve industriale të importuara për tu shitur në tregun vendas,

## **INSTAT llogarit dhe publikon:**

Indeksin e Çmimeve të Importit

Ndryshimet tremujore dhe vjetore të indeksit

## **Fusha e mbulimit:**

Seksioni B - Industri Nxjerrëse

Seksioni C – Industri Përpunuese

Seksioni D - Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar

Seksioni E - Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit

## **Llogaritja e indeksit**

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE rev,2) në nivel 2-shifror,

## **Matësit e Indeksit**

**Ndryshimi vjetor** mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar, Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori,

**Ndryshimi tremujor** mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korent dhe tremujorit të mëparshëm,